



- [Të Reja](#) [Policia e Shtetit](#) [Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptar](#) [Shërbime](#) [Baza ligjore](#) [Vendndodhjet e policisë](#) [Video](#)
- [Programi i transparencës](#) [Kontakt](#) [Denonco Krimin Kibernetik](#) [Drejtoritë Vendore të Policisë](#) [Policia Kufitare](#) [Policia Rrugore](#)
- [Donacione](#) [Rubrika Policimi në Komunitet](#) [Përmbledhja Javore](#) [Për sinjalizimin](#)

Breaking News:

Indeksi i shprehjes së besimit në policinë shqiptare rritet



Lajmet

24/03/2023

# Dibër – Kanosi Me Armë Zjarri Kallashnikov Bashkëfshatarin, Arrestohet Në Flagrancë 49-Vjeçari

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Dibër, menjëherë pas marrjes së njoftimit se në fshatin Vrenjt, një shtetas kishte qëlluar me armë zjarri në ajër, për të kanosur bashkëfshatarin e tij, kanë organizuar punën për kapjen dhe vënien në pranga të autorit të këtij rasti.

Falë ndërhyrjes në kohë dhe veprimeve profesionale, është parandaluar përshkallëzimi i mëtejshëm i këtij konflikti për motive pronësie, është kapur dhe është arrestuar në flagrancë shtetasi A. F., 49 vjeç, banues në fshatin Vrenjt, Dibër.

Nga veprimet hetimore paraprake dyshohet se 49-vjeçari, në fshatin Vrenjt, ka qëlluar me armë zjarri kallashnikov në ajër, për të kanosur për motive pronësie, shtetasin M. F., 25 vjeç (bashkëfshatar i tij).

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër për veprime të mëtejshme.

◀ Gjirokastër – Finalizohet operacioni policor i koduar “Katrori”

Raporti ditor i ngjarjeve, 24 mars 2023 ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON  
Google Play

Download on the  
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)